

# STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "MINERAL INSPECTION" SH.P.K.

## HYRJJE

### *NENI 1*

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "MINERAL INSPECTION" Sh.p.k. nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar qe krijohet mbi bazën e iniciativës dhe kapitalit themeltar të ortakeve:Alban Haxhi Bajrami

në bazë të aktit të themelimit datë 16 dhjetor 2019 krijojne shoqerine private për të ushtruar aktivitetin e saj si person juridik i pavarur.

### *NENI 2*

Shoqëria krijohet dhe e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me normat e këtij Statuti, Ligjit 9901dt 14/4/2008 "Për Shoqëritë Tregtare dhe tregetaret" si dhe Legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

### *NENI 3*

Kjo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, i përballon humbjet e saj deri në kufirin e vlerës së kapitalit themeltar.

## EMËRTIMI, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA

### *NENI 4*

Emërtimi i Shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar është:"MINERAL INSPECTION" SH.P.K.

### *NENI 5*

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar"MINERAL INSPECTION " Sh.p.k. ka Selinë e saj ne Tirane,Njesia Bashkiake Nr 2.Rruga "Todi Shkurti".Pallati Grand,Apartamenti nr 35. Aktiviteti i Shoqërisë do të zhvillohet në Rrethin e Tiranës dhe do të shtrihet në të gjithë territorin shtetëror të Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

## O B J E K T I

### *NENI 6*

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "MINERAL INSPECTION"Sh.p.k. do të jetë ne fushen e:

- 1-Inspektimit te cilesise dhe sasise se stoqeve te mineraleve ne Shqiperi
- 2-Perpunimin e mineraleve dhe mbetjeve te ndryshme
- 3-Import-Eksport te pajisjeve te ndryshme industriale
- 4-Import Eksport te produkteve te ndryshme industriale.

- 5-Laborator fiziko-kimike per perpunimin dhe analizimin e mineraleve te ndryshem  
6-Sherbime konsulence ne fushen minerare per kompani te ndryshme.

#### *NENI 7*

Shoqëria themelohet për të ushtruar veprimtarinë e saj për një periudhë mbi 10 vjet, duke filluar nga koha e regjistrimit në regjistrin tregëtar të QKR. Për shkaqe e arsye të ndryshme, ajo mund të mbarojë aktivitetin e saj dhe para këtij afati. Kjo do të bëhet në përputhje me normat e Statutit dhe Legjislacionit në fuqi.

### KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

#### *NENI 8*

Kapitali bazë i themelimit të Shoqërisë është 50.000 lekë, kontribut i ortakeve të shoqërisë.

Kuotat e kapitali themeltar zotërohen si më poshtë:

1-Ortaku themelues Alban Haxhi Bajrami zotërruesi nje (1) kuote me vlere te pergjithshme 50.000 lek qe perben 100% te kapitalit themeltar

Kapitali mund të jete jete ne para apo ne natyre

Ortakët e shoqërisë janë përgjegjës ndaj Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar për të gjitha detyrimet e marra përsipër dhe përgjigjen për humbjet deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Fondet monetare të Shoqërisë mund të përdoren për zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarisë së saj ekonomiko financiare.

#### *NENI 9*

Ortakët mund të shtojnë ose pakësojnë kapitalin e tyre sipas procedurave të përcaktuara në ligj.

#### *NENI 10*

Kapitali themeltar mund të shtohet ose të zvogëlohet, në varësi të rezultateve dhe në përputhje me normat e legjislacionit në fuqi.

#### *NENI 11*

Kapitali themeltar mund të transferohet jashtë Shoqërisë, ose të lihet peng, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### *NENI 12*

Kapitali themeltar është lehtësisht i transferueshëm në rrugë trashëgimie. Bashkëshorti, paraardhësit dhe pasardhësit mund të bëhen ortakë në Shoqëri nëpërmjet transferimit të pjesëve të kapitalit dhe sipas kushteve të parashikuara me ligj.

### *NENI 13*

Shoqëria mund të ketë dhe kontribute të tjera në natyrë. Këtu përfshihen të gjitha sendet e paluajtëshme në shërbim të Shoqërisë si dhe ato të luajtëshme, të cilat kalojnë në pronësi të Shoqërisë.

## FONDET E SHOQËRISË

### *NENI 14*

Shoqëria përcakton fondet:

- Fondi themeltar (qarkullues);
- Fondi rezervë;
- Fonde të tjera, që mund të jenë të nevojshme gjatë veprimtarisë së saj.

Madhësia e secilit fond përcaktohet mbi bazën e vendimit të organit drejtues, i cili merr vendim gjithashtu edhe për qëllimin e përdorimit të tij.

## DREJTIMI ADMINISTRATIV

### *NENI 15*

Shoqëria ka si organe drejtuese:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori.

Administrator i shoqërisë është zoti .Administratori është i zgjedhur për 5 vjet me të drejtë rizgjedhje.

### *NENI 16*

Asambleja e ortakëve për administrimin e Shoqërisë ose të aktiviteteve të veçanta të saj ka kompetencë të emërojë një ose disa persona të tjerë si administratorë të Shoqërisë. Kompetencat e administratorëve të mundshëm përcaktohen në aktin e emërimit të tyre.

### *NENI 17*

Shoqëria nuk merr përsipër veprimet që mund të kryejnë administratorë të tjerë të mundshëm, në marrëdhënie me persona të tretë që i tejkalojnë kompetencat e tyre të përcaktuara në aktin e emërimit.

### *NENI 18*

E gjithë veprimtaria e Shoqërisë administrohet nga administratori i saj në përputhje me Statutin dhe legjislacionin në fuqi.

### *NENI 19*

Administratori për të shqyrtuar bilancin vjetor, të ardhurat e qarkulluara, si dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrave të veprimeve kontabël, emëron një ose disa ekspertë kontabël. Emërimi i ekspertëve kontabël është i detyrueshëm për rastet e parashikuara me ligj.

## ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

## TE DREJTAT DHE DETYRIMET NENI 20

- Përcakton politikat tregëtare të shoqërisë
  - Ndryshimet e statutit
  - Emëron dhe shkarkon administratorët dhe përcakton kompetencat e tyre në aktin e emërimit.
  - Emeron dhe shkarkon likuiduesit dhe ekspertet kontabel të autorizuar
  - Përcakton shpërblimin e administratorit dhe të likuiduesit dhe eksperteve.
  - Mbikqyr zbatimin e politikave tregëtare nga administratorët, pasqyrat financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së shoqërisë
  - Zmadhimin apo zvogëlimin e kapitalit
- 
- Shqyrton bilancin vjetor, kuotat e fondeve të ndryshme dhe fitimin e realizuar.
  - Vendos për krijimin e filialeve, degëve ose përfaqësive të Shoqërisë si dhe për krijimin e shoqërive të përbashkëta.
  - Vendos për marrjen e kredive si dhe për mbarimin e aktivitetit të Shoqërisë, nëse në dokumentacionet financiare, rezultatet e Shoqërisë vlerësohen me humbje.
  - Realizon marrëdhëniet më të rëndësishme financiare dhe ekonomike të Shoqërisë me persona të tjerë fizikë dhe juridikë.
  - Të caktojë dhe shkarkojë drejtues teknik sipas drejtimeve të veprimtarisë që do të ushtrojë shoqëria (me kontrata pune).
  - Riorganizimin edhe prishjen e shoqërisë
  - Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjes së asamblese

## MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME NENI 21

Asambleja mbledhet sa herë që është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të shoqërisë, në rastet e përcaktuara me ligj, e në të gjitha rastet jo më pak se një herë në vit.

Ajo thirret nga administratori ose ortakët.

Thirret me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, ditën, datën orën e mbledhjes dhe rendin e ditës, e të dërgohet ortakëve jo më vonë se shtatë ditë para datës së parashikuar për mbledhje.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamble vete ose edhe nga një person i autorizuar prej tij, ose nga ortak tjetër.

Vendimet merren unanimisht nga të dy ortakët.

## KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

### NENI 22

Administratori e shoqërisë ka për detyrë:

- Të punojë, të drejtojë e të organizojë në mënyrë të tillë që të sigurojë suksesin e Shoqërisë në veprimtarinë e saj ekonomiko-financiare, sipas politikës tregëtare të vendosur nga asambleja e përgjithshme.
- Të përfaqësoj shoqërinë tregëtare
- Të kujdeset për mbajtjen e sakte dhe të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqërisë

- Te Pregatise dhe nenshkruaj bilancin vjetor bilancin e konsoliduar; dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe vazhdimesine e saj, se bashku me propozimin per shperndarjen e fitimeve dhe paraqit keto dokumente para asamblese se pergjithshme per miratim.
- Te Kryej regjistrimet dhe te dergoj te dhenat e detyrueshme te shoqerise sic parashikohet ne ligj Per QKB
- Te Raportoj para asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave trgetare
- Realizon dhe përcakton çmimet e punimeve të kryera si dhe të shitjeve të artikujve të tregtuar.
- Nenshkruan kontrate pune me punemarres
- Ndjek problemet e Shoqërisë në marrëdhëniet me organe të ndryshme shtetërore dhe me persona të tjerë fizikë dhe juridikë, lidh kontrata me te trete.

### DREJTIMI TEKNIK I SHOQËRISË

#### *NENI 23*

Për veprimtari në fusha të veçanta (në të cilat ligji përcakton drejtim nga specialistë të liçencuar), shoqëria do të punësojë me kontrata pune specialistë të liçencuar sipas fushës përkatëse.

### MARRËDHËNIET FINANCIARE

#### *NENI 24*

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar " Sh.p.k., mund të lidhë kontrata me sektorë shtetërorë, drejtpërdrejt me tregun e lirë, si dhe me persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj.

#### *NENI 25*

Në marrëdhëniet kontraktore, Shoqëria përfaqësohet nga administratori ose nga persona të autorizuar prej tij. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat janë të detyrueshme për Shoqërinë.

#### *NENI 26*

Shoqëria ka të drejtë të plotë të çelë llogari likuiduese pranë Bankave të vendit ose të huaja në Shqipëri, shtetërore ose private dhe të kryejë veprimet e likuidimit nëpërmjet tyre. Për sigurimin e veprimtarisë ka të drejtë të vetëfinancohet në lekë ose në valutë të huaj.

#### *NENI 27*

Shoqëria përgjigjet për kontributet fiskale, afatet e derdhjes së tyre dhe sigurimet shoqërore. Personat e ngarkuar me këtë detyrë duhet të mbajnë dokumentacion të rregullt financiar.

Administratori në fund të vitit duhet të dorëzojë në organin tatimor përkatës bilancin e të ardhurave për efekt të tatimit vjetor.

Viti financiar mbaron në muajin dhjetor të çdo viti. Raportet dhe inventaret vjetore hartohen në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe Legjislacionin në fuqi.

### MARRËDHËNIET E PUNËSIMIT

#### *NENI 28*

Administratori vendos për personat që do të punësohen në aktivitetin e Shoqërisë. Punësimi do të bëhet në përputhje me aftësitë profesionale të punëmarrësit.

#### *NENI 29*

Marrëdhëniet e punësimit rregullohen sipas kontratës së punësimit që lidhet midis palëve, në bazë të Kodit të Punës dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Në kontratë caktohen kushtet e punës, të pagesës, sigurimit në punë, ditëve të pushimit etj.

#### *NENI 30*

Administratori dhe personeli i Shoqërisë është i detyruar të respektojë disiplinën e punës, të ruajë dhe të mirëmbajë pronën dhe të zhvillojë aktivitetin e Shoqërisë në përputhje me ligjin.

#### *NENI 31*

Ndaj shkeljeve të ndryshme zbatohen masa disiplinore që merren nga administratori. Punonjësi që largohet nga puna duhet të bëjë dorëzimet e detyrës në bazë të një akti me shkrim, pasi të ketë shlyer detyrimet materiale dhe monetare.

### PËRGJEGJËSIA E PUNONJËSVE

#### *NENI 32*

Çdo punonjësi i punësuar në Shoqëri është personalisht përgjegjës për kryerjen e detyrës. Ai është i detyruar të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës, nga vendimet e administratorit dhe nga Statuti i Shoqërisë. Për shkelja të tilla dhe për shkelje të Legjislacionit në fuqi merren masa të ndryshme sipas ligjit.

### KONFIDENCIALITETI

#### *NENI 33*

Të gjithë personat që do të punësohen në shoqëri janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e dokumentacionit, të informacionit, të njohurive të fituara si dhe të çdo lloj materiali tjetër konfidencial.

Ata duhet të adaptojnë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar hapjen e këtyre qoftë edhe pjesërisht.

### BILANCI DHE TË ARDHURAT

#### *NENI 34*

Të ardhurat neto, pas shlyerjes së detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore dhe detyrimeve të mundshme ndaj personave të tretë, kalojnë në dispozicion të ortakeve sipas kontributit të përcaktuar

#### *NENI 35*

Pagesat e personelit bëhen sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e punës dhe përqindjeve të fitimit të përcaktuara nga organi administrativ

#### *NENI 36*



Në rast të mbarimit të veprimtarisë së Shoqërisë, fitimi i realizuar duke zbritur ose duke shtuar përqindjet e mbartura nga vitet e mëparshme, kalojnë në dispozicion të ortakevesipas mases së kuotave që zoterojnë në shoqëri

#### *NENI 37*

Çmimet e shërbimeve të ofruara nga Shoqëria si dhe ato të tregtimit caktohen në bazë të parimeve të ekonomisë së tregut të lirë. Fitimet e realizuara i nënshtrohen tatimit vjetor të përcaktuar në dispozitat përkatëse ligjore.

### SHPËRBËRJA E SHOQËRISË

#### *NENI 38*

##### *SHKRIRJA*

SHOQËRIA mbaron me të përfunduar afati i parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji ose me anë të një vendimi të asamblese së përgjithshme, dhe për shkak të tjera ligjore-faementim etj.

#### *NENI 39*

##### *LIKUJDIMI*

Në rast mbarimi, SHOQËRIA duhet të likujdohet, duke iu nënshtuar procedurave të likuidimit.

Për të administruar këtë procedurë, asambleja e përgjithshme e ortakeve emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të SHOQËRISË, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

Me përfundimin e procedurës së likuidimit të SHOQËRISË, asambleja e ortakeve vendos mbi bilancin vjetor përfundimtar, mbi vlefshmërinë e punës së kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

Pas pagesës së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'idorëzojë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakeve themelues, (sipas përqindjeve të kuotave që do të zotërojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë).

#### *NENI 40*

Shoqëria mund të mbarojë edhe me anë të riorganizimit, nëpërmjet formave të thithjes ose të bashkimit.

#### *NENI 41*

Gjatë fazës së likuidimit, përgjegjësia e administratorit dhe likuidatorit është e njëjtë.

### DISPOZITA TË FUNDIT

#### *NENI 42*

Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet në ndonjë institut sigurimi.

#### *NENI 43*

Mosmarrëveshjet në marrëdhënie me persona juridikë e fizikë, vendas e të huaj, zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt, gjykata kompetente është Gjykata e Rrethit Tiranë.

*NENI 44*

Çdo gjë tjetër në këtë Shoqërië i referohet Ligjit Nr.9901, dt 14/4/2008 "Për Shoqëritë Tregtare dhe tregtaretdhe çdo akti tjetër të legjislacionit shqiptar.

*NENI 45*

Shoqëria do të ketë vulën e saj forma dhe përmbajtja e së cilës përcaktohet nga ortaket .

Statuti i Shoqërisë u miratua nga ortaket dhe u nenshkrua prej tyre.

ORTAKET E SHOQERISE

Alban Bajrami

A stylized handwritten signature consisting of a large, sweeping 'A' shape with a horizontal line extending to the right, crossing the vertical stem of the 'A'.